



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 21.08.2024

Nr: 17

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 9, DATË 03.08.2024 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI “PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 21.08.2024, me pjesëmarrjen e:

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Illirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia Bashkimi Për Të Dretjtat e Njeriut

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë z. Dhionisios (Alfred) Beleri, propozuar nga koalicioni Bashkë Fitojmë”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 12/5, 7, neni 21, pika 1 shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 21.08.2024 Nr: 17  
Ora: 11:00



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 të depozituar nga subjekti “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”

## VËREN:

Subjekti “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njëriut”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 09 regj., datë 03.08.2024.

Në mbledhjen e datës 21.08.2024, pas relativitetit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 09, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 09, datë 03.08.2024, të paraqitur nga subjekti “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njëriut”.
2. Kërkesa ankimore do të shqyrtohet në seancën e datës 12.09.2024, ora 11:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>Lako</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>Çefa</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilijan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>